3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

## **D. DHËNIA E KONTRATËS**

### **23. Njoftimi i Fituesit**

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

### **24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

---

## **DH. ANKESAT**

### **25. Procedura e ankesës**

1. Cdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

## **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

### **26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.





---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës.....	.....
Shtojca 2. Lista e Çmimeve të Sherbimeve .....	.....
Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës.....	.....
Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial .....	.....
Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike .....	.....
Shtojca 6. Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit .....	.....
Shtojca 7. Termat e referencës	
Shtojca 8. Formulari i Kriereve te Përzgjedhjes se Ofertuesve .....	.....
Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....	.....
Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit .....	.....
Shtojca 11 - Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak) .....	.....
Formulari 12 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)	
Shtojca 13 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)	
Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)	

## Shtojca 1.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  2. Njoftimin e Kontrates;
  3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
  5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
<b>Shërbimi</b>	<b>Përshkrimi i shërbimi</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total për shërbim(3 x 4X)</b>	
1	"Hartimi i Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike"	1 shërbim			
	<b>Çmimi total (Shërbimet)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					

<b>Datë</b> _____	
-------------------	--

**Shtojca 3.**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]  
[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;

- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së

---

ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

---

## Shtojca 5.

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:



## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: Qëllimi i hartimit të Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike është përcaktimi dhe marrja e masave prioritare ndaj ndikimit të ndryshimeve klimatike për të shmangur efektet negative, uljen e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe të përshpejtojë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në territorin e administruar nga Bashkia e Tiranës.

Vlerësimi i situatës aktuale duhet të japë një pamje të qartë për vulnerabilitetet ndaj ndryshimeve klimatike në territorin e Bashkisë Tiranë. Shumë elemente të prekshmërisë (vulnerabilitetit) kanë të bëjnë me sektorët e veprimtarive shoqëro-ekonomike (bujqësia, energjetika, shëndetësia, pyjet, turizmi, etj.) dhe shumica e efekteve negative parashikohen se do të rriten në shkallë në të ardhmen. Ndryshimet klimatike pritet të ndikojnë ndjeshëm edhe në sistemet natyrore përfshirë sistemet hidrologjike dhe ekosistemet natyrore, por ato mund të ndikojnë edhe në shtimin e reshjeve dhe fatkeqësive të lidhura me klimën apo edhe pabarazinë dhe vulnerabilitetin social.

**Afatet e ekzekutimit: 6 (gjashtë) muaj nga data e lidhjes së kontratës.**

1. 2. Nr.	3. 4. Grafiku sipas detyrave	5. MUAJT E VITIT				6.	7.
		8. I	9. II	10. III	11. IV		
14. 1	Grumbullimi i të dhënave për vlerësimin e gjendjes fillestare	15. x	16.	17.	18.	19.	20.
21. 2	Takim me palët e interesit për të adersuar propozimet në lidhje me hartimin e dokumentit	22.	23. x	24.	25.	26.	27.
28. 3	Përgatitja e materialeve për profilet e emetimeve GES për sektorët e përzgjedhur; raporti për analizën fillestare dhe identifikimin e rreziqeve dhe vulnerabiliteteve si	29.	30. x	31. x	32.	33.	34.

	pasojë e ndryshimeve klimatike në sektorët e përzgjedhur						
35.4	Përgatitja e masave konkrete sipas sektorëve që ndikojnë në ndryshimet klimatike	36.	37.	38. x	39. x	40.	41.
42.5	Përgatitja dhe konsultimi i dokumentit me palët e interesit	43.	44.	45.	46.	47. x	48.
49.6	Përgatitja e draft-planit të veprimit duke marrë parasysh komentet nga autoriteti kontraktor dhe dorëzimi i dokumentit final	50.	51.	52.	53.	54. x	55. x

## Shtojca 7

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### TERMAT E REFERENCES

Shërbimi që kërkohet: **HARTIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE, BASHKIA TIRANË**

### PËRMBAJTJA

#### 1. FJALOR

2. KONTEKSTI AKTUAL
3. QËLLIMI I PUNËS DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE
4. GRUPI I PUNËS
5. DETYRAT E KONTRAKTORIT (TERMAT E REFERENCËS)
6. AFATI I HARTIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE
7. FONDI LIMIT PËR HARTIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE
8. MONITORIMI I FAZAVE TË HARTIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE
9. MIRATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE
10. REFERENCA LIGJORE

## 1. FJALOR

Në këtë material janë përdorur përkufizimet si më poshtë:

Ndryshim klimatik	Është një ndryshim i klimës, që i atribuohet direkt apo indirekt aktivitetit të njeriut, i cili ndryshon përbërjen e atmosferës globale dhe që i shtohet ndryshueshmërisë natyrore të klimës, që vërehet në periudha kohe të krahasueshme
Efekte të dëmshme të ndryshimeve klimatike	Janë ndryshimet në mjedisin fizik apo biotë që rezultojnë nga ndryshimet klimatike, të cilat kanë efekte të rëndësishme negative mbi shëndetin dhe mirëqenien e njeriut e të kafshëve blegtorale
Gaz me efekt serrë (GES)	Janë gazet që gjenden në atmosferë në gjendje natyrore dhe të shkaktuara nga aktivitetet antropogjene, të cilat përthithin dhe rriemetojnë rrezatimin infra të kuq
Shkarkime	Janë çlirimet nga aktivitetet antropogjene të GES-it dhe/ose prekursorëve të tyre në atmosferë, në një sipërfaqe dhe periudhë kohe të caktuar.

Burim	Është çdo proces apo aktivitet që çliron një GES, një aerosol apo një prekursor të GES-it nga atmosfera
Djegje	Është oksidimi i lëndës djegëse, pavarësisht mënyrës sesi përdoret nxehtësia, energjia elektrike apo mekanike e prodhuar nga ky proces, dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet drejtpërdrejt me të, përfshirë pastrimin e mbetjeve të gazta
Politika/masa	Janë të gjitha instrumentet që synojnë të zbatojnë angazhimet që lidhen me zbutjen e ndryshimeve klimatike, duke kufizuar shkarkimet antropogjene të GES-it
Përshtatje	Janë rregullimet e bëra nga njeriu në sistemet ekologjike, sociale, ekonomike ose proceset politike, në përgjigje të ndryshimeve aktuale apo të pritshme të klimës, efekteve apo ndikimeve të tyre.
Zbutje	Janë të gjitha përpjekjet e bëra për të reduktuar apo parandaluar shkarkimet e GES-it, përfshirë përdorimin e teknologjive të reja dhe energjive të rinovueshme, që i bëjnë pajisjet e vjetra më efikente ndaj konsumit të energjisë, që ndryshojnë praktikatat e menaxhimit apo sjelljen e konsumatorit
Inventari i GES-it	Është inventari i shkarkimeve, që përfshin shkarkimet e GES-it nga kategoritë e burimeve, si dhe përthithjen e tyre nga përthithësit e karbonit

## 2. KONTEKSTI AKTUAL

Një nga sfidat më të mëdha me të cilat po ballafaqohet bota sot janë ndryshimet klimatike. Çdo ditë jemi dëshmitar të ndryshimeve drastike të motit të cilat rrjedhimisht ndryshojnë dhe kushtet klimatike. Ndryshimet e klimës përcaktohen si ndryshimet në nivel global, për një periudhë të gjatë kohore të disa prej parametrave klimatikë, si temperatura e ajrit, niveli i reshjeve dhe pasojat që ato kanë në ekosistemet.

Ndryshimet klimatike ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, ndërsa efektet e saj kanë pasojat në cënueshmërinë e shoqërisë. Ndryshimet klimatike tani janë duke ndodhur, ndërsa në vitet dhe dekadat e ardhshme do të rrisin ndikimin në elementet themelore të jetës kudo në botë, në Shqipëri, por edhe në Tiranë. Ndikimet do të jenë të mëdha në rezervat e ujit, prodhimin e ushqimit, shëndetësi dhe mjedisin jetësor. Mostrajtimi i ndikimeve nga ndryshimet klimatike mund të shkaktojë çrregullime të konsiderueshme ekonomike dhe mjedisore. Prandaj, është e qartë nevoja që ndryshimet klimatike dhe ndikimet e saj të integrohen në politikat zhvillimore, strategjitë dhe planet e veprimt.

Ndryshimi shumë i shpejtë i klimës që po shohim këto vitet e fundit, po shkaktohet nga shkarkimet nga aktiviteti njerëzor i gazeve serrë ku më të zakonshmit janë dyoksidi i karbonit (CO<sub>2</sub>) dhe gazi metan (CH<sub>4</sub>).

Këto gaze të dëmshëm gjenerohen nga përdorimi i benzinës për drejtimin e një makine, bujqësia, operacionet e naftës dhe gazit, të cilat janë janë burimet kryesore të emetimeve të metanit. Energjia, industria, transporti, ndërtesat, bujqësia dhe përdorimi i tokës janë ndër sektorët kryesorë që shkaktojnë gazet me efekt serrë. Shumë njerëz mendojnë se ndryshimi i klimës nënkupton kryesisht temperatura më të larta. Por rritja e temperaturës është vetëm fillimi i historisë. Për shkak se Toka është një sistem, ku gjithçka është e lidhur, ndryshimet në një zonë mund të ndikojnë në ndryshimet në të gjitha të tjerat.

Efektet e dëmshme të Ndryshimeve Klimatike tani përfshijnë, ndër të tjera, thatësira intensive, mungesë uji, zjarre të rënda, rritje të nivelit të detit, përmytje, shkrirje të akullit polar, stuhi katastrofike dhe humbie të biodiversitetit.

Aktualisht, Bashkia e Tiranës ka një dokument për sa i përket adaptimit për Ndryshimet Klimatike: “Vlerësimi i Cënueshmërisë dhe Adaptimi i Planit të Veprimit për Tiranën”. Duke qenë se ky dokument është i vitit 2015 dhe me ndryshimet e shumta që ka pësuar Tirana përgjatë viteve të fundit, në popullsi dhe territor duke u rritur në mënyrë të vazhdueshme (nga 780.531 në vitin 2015 në 863,694 banorë në vitin 2021) dhe (nga 42 km<sup>2</sup> në vitin 2015 në 1,111.00 km<sup>2</sup>), ky dokument është i pamjaftueshëm dhe nuk i përgjigjet sfidave të shumta me të cilat përballet qyteti. Shtimi i territorit dhe popullsisë sjell rrjedhimisht rritjen e numrit të vendbanime; rritjen e përdorimit të mjeteve të transportit; rritjen e prodhimit të produkteve bujqësore e blegtorale; e padyshim që të gjithë këta faktorë ndikojnë drejtëpërsëdrejti në rritjen e emetimeve të GES. Për këtë arsye lind nevoja e hartimit të një Plani të ri Veprimi për Ndryshimet Klimatike, i cili do të adresojë të gjitha çështjet që lidhen me ndryshimet klimatike në periudhë afatgjatë.

### **3. QËLLIMI I PUNËS DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE**

Qëllimi i hartimit të Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike është përcaktimi dhe marrja e masave prioritare ndaj ndikimit të ndryshimeve klimatike për të shmangur efektet negative, uljen e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe të përshpejtojë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në territorin e administruar nga Bashkia e Tiranës.

Vlerësimi i situatës aktuale duhet të japë një pamje të qartë për vulnerabilitetet ndaj ndryshimeve klimatike në territorin e Bashkisë Tiranë. Shumë elemente të prekshmërisë (vulnerabilitetit) kanë të bëjnë me sektorët e veprimtarive shoqëro-ekonomike (bujqësia, energjetika, shëndetësia, pyjet, turizmi, etj.) dhe shumica e efekteve negative parashikohen se do të rriten në shkallë në të ardhmen. Ndryshimet klimatike pritet të ndikojnë ndjeshëm edhe në sistemet natyrore përfshirë sistemet hidrologjike dhe ekosistemet natyrore, por ato mund të ndikojnë edhe në shtimin e reshjeve dhe fatkeqësive të lidhura me klimën apo edhe pabarazinë dhe vulnerabilitetin social.

---

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike është një proces afatgjatë dhe plani i veprimit duhet të ofrojë elementet kuadër të këtij procesi, si: parimet, objektivat, treguesit, veprimet prioritare, planet e financimit, strategjitë e informimit dhe përfshirjes, zhvillimi i kapaciteteve, monitorimi dhe rishikimi. Planin e veprimit duhet të ofrojë një kuadër për integrimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike në sektorët e tjerë të zhvillimit. Ai duhet të shërbejë si mbështetje për të identifikuar mundësitë për financim sistematik dhe si katalizator për sigurimin e pjesëmarrjes dhe ndërgjegjësimin e aktorëve të interesuar dhe publikut të gjerë.

Planin e Veprimit për Ndryshimet Klimatike do të jetë një dokument planifikimi strategjik, që mundëson zbatimin e politikës kombëtare në fushën e ndryshimeve klimatike në nivel vendor. Planin do të tregojë një drejtim për të ardhmen dhe do të nxisë mendimin e përbashkët mes palëve të interesit dhe jo vetëm, që janë të përfshirë në procesin e planifikimit, hartimit, zbatimit të masave praktike dhe veprimeve konkrete në lidhje me ndryshimet klimatike.

Planin e Veprimit për Ndryshimet Klimatike do të jetë një dokument bazë që do të orientojë masa konkrete, afate kohore të mirë përcaktuara, struktura përgjegjëse për zbatimin e masave si dhe buxhetet përkatëse për çdo masë, me qëllim ndërhyrjen në çdo sektor për t'u përshtatur me ndryshimet klimatike dhe zbutjen ndaj ndikimeve të tyre, në territorin e administruar nga Bashkia e Tiranës.

Objektivi i përgjithshëm i Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike, është të kontribuojë në uljen e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, të zvogëlojë ndikimet nga to, duke rritur aftësinë zbutëse si dhe të përshpejtojë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në territorin e Bashkisë Tiranë, në proceset e menaxhimit të qëndrueshëm dhe planifikimit brenda sektorëve të ndryshëm të qytetit, si dhe projektet strategjike.

Planin e veprimit për ndryshimet klimatike duhet të hartohet në përputhje me objektivat dhe rekomandimet e “Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike dhe Planet e Veprimit” duke kontribuar në zbatimin e politikave të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe arritjen e objektivave kombëtare në nivel lokal.

Planin e veprimit duhet të ndjekë udhëzimet teknike për hartimin e Planeve të Veprimit për ndryshimet klimatike (UNFCCC).

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike është e lidhur ngushtë me planifikimin afatgjatë të zhvillimit urban, burimeve ujore, bujqësisë, ruajtjes së natyrës dhe zhvillimit të territorit. Prandaj përfshirja e përshtatjes klimatike në sektorët e linjës që preken nga ndryshimet klimatike, është një qasje e efektshme. Vetëm në këtë mënyrë përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike mund të shndërrohet në kontribues për zhvillimin, dhe mund të ndihmojë në sigurimin e rritjes ekonomike.

Masat e parashikuara për zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike (reduktim i shkarkimeve ose rritje e përthithësve) mund të përfshijnë masa direkte (masa që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë për sa

i përket reduktimit të shkarkimeve ose rritjes të përthithësve të karbonit); masa indirekte (masa që do të çojnë te një reduktim indirekt i shkarkimit ose rritje të përthithësve të karbonit (p.sh. trajnime dhe rritje të ndërgjegjësimit, skema certifikimi, financimi etj.); dhe masa mundësuese (masa që janë funksionale për aplikimin e masave direkte/indirekte (p.sh. forcimi i planifikimit territorial, përforcimi i marrëveshjeve institucionale, monitorimi etj.). Masat e parashikuara mund të përfshijnë sektorë të veçantë si energjia, transporti, bujqësia apo përdorimi i territorit, por plani i veprimit duhet të parashikojë edhe masa ndër-sektoriale, veçanërisht ndërmjet sektorit pyjor dhe atij energjetik, lidhur me sigurimin e burimeve të qëndrueshme të energjisë së rinovueshme; ndërmjet sektorit bujqësor dhe energjetik, lidhur me përmirësimin e pajisjeve për energjinë efikase në praktikat bujqësore.

Plani i veprimit duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë edhe sistemit të matjes, monitorimit dhe raportimit për ndryshimet klimatike. Vlerësimi i plotë, standard dhe transparent për raportimin dhe përgjegjësinë ndaj shkarkimeve dhe përthithësve të gazeve me efekt serë (GES), është thelbësor për të vlerësuar progresin e arritjes së objektivave, për të vlerësuar performancën e politikave dhe masave në nivel kombëtar, dhe për të vlerësuar suksesin e përpjekjeve të përbashkëta për të reduktuar ndryshimet klimatike.

Në mënyrë specifike, plani i veprimit për ndryshimet klimatike i Bashkisë Tiranë duhet të synojë:

- ◆ Pakësimin i ndikimeve negative që ndryshimet klimatike sjellin, si pasojë e fatkeqësive natyrore si përmbytjet, thatësira, valët e të nxehtit, i ftohti ekstrem etj.
- ◆ Uljen e gjurmës së karbonit për të shkuar drejt objektivave të Bashkimit Evropian.
- ◆ Reduktimin në mënyrë të qëndrueshme të emetimeve të karbonit nga sektorët që e prodhojnë atë (transporti, industria, bujqësia etj.)
- ◆ Sigurimin e pjesëmarrjes së gjerë të popullsisë lokale në vendimmarrjen për ndryshimet klimatike dhe rëndësinë e tyre.
- ◆ Krijimi i një modeli nxitës për aktivitete ndërgjegjësimi, edukimi dhe informimi që mbështesin veprimet e uljes së shkarkimeve.

Plani i veprimit duhet të kontribuojë edhe në arritjen e Objektivit 13 për Zhvillimin e Qëndrueshëm (SDG13), i cili kërkon marrjen e masave urgjente për të parandaluar Ndryshimet Klimatike dhe ndikimet e tyre në territorin e administruar nga Bashkia Tiranë.

#### **4. GRUPI I PUNËS**

Grupi i punës i ngritur me Urdhrin Nr. 1268 datë 24.04.2024 dhe nr. 15657/1 prot., datë 24.04.2024 të Zv/Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e termave të referencës dhe përcaktimin e fondit limit, konform legjislacionit në fuqi për realizimin e shërbimit “Hartimin e Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike”,

---

## 5. DETYRAT E KONTRAKTORIT (TERMAT E REFERENCËS)

Termat e referencës me të gjithë elementët përbërës janë hartuar mbështetur në Ligjin Nr. 155/2020 “Për Ndryshimet Klimatike”, Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Veprimit.

Këto terma reference do të shërbejnë për të përcaktuar përgjegjësitë, detyrat dhe kualifikimet e kërkuara për kontraktorin që do të përgatisin Planin e Veprimit për Ndryshimet Klimatike, Bashkia Tiranë.

Kontraktori është përgjegjës për realizimin e detyrave si më poshtë:

### 1. Raporti i Vlerësimit të Klimës:

Detyra 1.1: Grumbullimi, analizimi i të dhënave dhe shqyrtimi i literaturës për të vlerësuar gjendjen aktuale për sa i përket ndryshimeve klimatike në territorin e Bashkisë Tiranë (në këtë pjesë do të bashkëpunohet me stafin e Bashkisë për të dhënat ekzistuese).

Detyra 1.2: Identifikimi i riskut dhe vulnerabilitetit të lidhur me ndryshimet klimatike.

Detyra 1.3: Përgatitja e draft-raportit të analizës së situatës aktuale.

Detyra 1.4: Konsultimi me aktorët e përfshirë dhe rishikimi i nevojshëm i raportit.

### 2. Inventarizimi i gazeve me efekt serrë

Detyra 2.1: Grumbullimi i të dhënave mbi emetimet e gazeve me efekt serrë.

Detyra 2.2: Përgatitja e profilit të emetimeve të gazeve me efekt serrë.

Detyra 2.3: Rekomandime për sigurimin e një modeli të qëndrueshëm të ekonomisë në përputhje me reduktimin e shkarkimeve të GES.

### 3. Zhvillimi i qëllimit strategjik dhe objektivave të planit

Detyra 3.1: Zhvillimi i një vizioni, misioni dhe objektivi kryesor për ndryshimet klimatike.

Detyra 3.2: Konsultimi i vizionit, misionit dhe objektivit kryesor me aktorët e përfshirë.

Detyra 3.3: Rekomandime për integrimin e masave të përshtatjes me ndryshimet klimatike në të gjitha dokumentet planifikuese dhe protokollet teknike të Bashkisë Tiranë.

### 4. Përgatitja e Planit të Veprimit

Detyra 4.1: Rekomandime dhe plani i masave konkrete për ndërhyrje, me afate të përcaktuara, strukturat përgjegjëse për zbatimin si dhe kostot për zbatimin e secilës masë, sipas sektorëve që ndikojnë në ndryshimet klimatike.



Detyra 4.2:Plani i monitorimit të menaxhimit dhe aktiviteteve që pritet të zhvillohen në zonë.

Detyra 4.3: Diskutimi dhe konsultimi i aktiviteteve kryesore të planifikimit dhe zbatimit të planit të veprimit me palët e interesuara.

Detyra 4.4: Konsultimi i draft-planit të veprimit me aktorët vendimmarrës (Bashkia Tiranë, MTM, Njësitë Administrative, banorët, shoqatat, fakultetet etj.).

Masat e rekomanduara duhet të përfshijnë veç të tjerash edhe masa që lidhen me shtimin e hapësirave të gjelbra, lëvizshmërinë alternative dhe transportin e qëndrueshëm, përdorimin e burimeve të energjisë së rinovueshme, nxitjen e ekonomisë qarkulluese, përdorimin e qëndrueshëm të tokës, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, forcimin e kapaciteteve për adresimin e rreziqeve që lidhen me klimën dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi efektet e ndryshimeve klimatike.

## 5. Ngritja e Kapaciteteve

Detyra 5.1: Forcimi i kapaciteteve të institucionit të Bashkisë Tiranë dhe bashkëpunim ndërinstytucional për trajtimin e zbutjeve të ndryshimeve klimatike.

Detyra 5.2: Forcimi i kapaciteteve institucionale për evidentimin e emetimeve të GES dhe llogaritjen e tyre.

## 6. AFATI I HARTIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

Për realizimin e hartimit të Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike parashikohet një afat kohor që nuk mund të jetë më shumë se **6 muaj nga fillimi i zbatimit të kontratës me subjektin e kontraktuar.**

Për zbatimin e kontratës në fazën e grumbullimit të të dhënave do të kërkohet angazhimi i stafit të Bashkisë për lehtësimin e komunikimit me sektorë të ndryshëm.

Kontraktori duhet të parashikojë dhe të detajojë në mënyrë të saktë të gjitha fazat e punës së domosdoshme deri në momentin final, atë të miratimit dhe dorëzimit të produktit përfundimtar.

### Grafiku i dorëzimit të Raportit përfundimtar për këtë objekt:

56. 57. Nr.	58. 59. Grafiku sipas detyrave	60. MUAJT E VITIT				61.	62.
		63. I	64. II	65. III	66. IV	67. V	68. VI
69. 1	Grumbullimi i të dhënave për vlerësimin e gjendjes fillestare	70. x	71.	72.	73.	74.	75.
76. 2	Takim me palët e interesit për të	77.	78. x	79.	80.	81.	82.

	adersuar propozimet në lidhje me hartimin e dokumentit						
<b>83. 3</b>	Përgatitja e materialeve për profilet e emetimeve GES për sektorët e përzgjedhur; raporti për analizën fillestare dhe identifikimin e rreziqeve dhe vulnerabiliteteve si pasojë e ndryshimeve klimatike në sektorët e përzgjedhur	<b>84.</b>	<b>85. x</b>	<b>86. x</b>	<b>87.</b>	<b>88.</b>	<b>89.</b>
<b>90. 4</b>	Përgatitja e masave konkrete sipas sektorëve që ndikojnë në ndryshimet klimatike	<b>91.</b>	<b>92.</b>	<b>93. x</b>	<b>94. x</b>	<b>95.</b>	<b>96.</b>
<b>97. 5</b>	Përgatitja dhe konsultimi i dokumentit me palët e interesit	<b>98.</b>	<b>99.</b>	<b>100.</b>	<b>101.</b>	<b>102. x</b>	<b>103.</b>
<b>104.</b>	Përgatitja e draft-planit të veprimit duke marrë parasysh komentet nga autoriteti kontraktor dhe dorëzimi i dokumentit final	<b>105.</b>	<b>106.</b>	<b>107.</b>	<b>108.</b>	<b>109. x</b>	<b>110. x</b>

---

## 7. FONDI LIMIT PËR HARTIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

Bashkia e Tiranës me qëllim përmbushjen e detyrimit ligjor për hartimin e Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike, nëpërmjet Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 36 datë 28.03.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.125, datë 22.12.2023 të Këshillit Bashkiak për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2024”, ka akorduar fondin për hartimin e Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike, si dhe me Urdhër të Zv/Kryetarit të Bashkisë Nr. 1268, datë 24.04.2024 dhe nr. 15657/1 prot., datë 24.04.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e termave të referencës dhe përcaktimin e fondit limit konform legjislacionit në fuqi për realizimin e shërbimit për hartimin e planit të veprimit për Ndryshimet Klimatike”.

Në përputhje me parashikimet e kuadrit ligjor në fuqi për prokurimin publik, nga ana e autoritetit kontraktor është realizuar përlllogaritja e fondit limit që do të përdoret për kontraktimin e subjektit/eve që do të hartojnë Planin e Veprimit për Ndryshimet Klimatike.

Fondi limit në total për hartimin e Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike është përlllogaritur në vlerën e **4,155,556** (katër milion njëqindë e pesëdhjetë e pesë mijë e pesë qindë e pesëdhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH ose 4,986,667** (katër milion e nëntëqindë e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtë qindë e gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë me TVSH**.

## 8. MONITORIMI I DETYRAVE TË HARTIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

Autoriteti kontraktor do të monitorojë realizimin e detyrave të ndryshme të hartimit të Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike dhe punimet që realizohen nga subjekti i kontraktuar nëpërmjet grupit të monitorimit që do të ngrihet me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor.

Grupi i monitorimit do të ketë në përbërje 3 specialistë nga Drejtoria e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Emergjencave Natyrore, pranë Bashkisë Tiranë, të cilët do të monitorojnë procesin e hartimit të Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike nga subjekti i kontraktuar në lidhje me:

- ✓ Zbatimin e detyrimeve kontraktuale në përgjithësi;
- ✓ Përmbushjen e kërkesave për punimet e terrenit dhe ato të zyrës;
- ✓ Zbatimin e detyrimeve kontraktuale në lidhje me numrin e punonjësve dhe kualifikimet profesionale të stafit të përfshirë në proces nga kontraktori;

- ✓ Respektimin e kriterëve tekniko-ligjore nga kontraktori gjatë procesit të hartimit të Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike;
- ✓ Zbatimin e afateve kohore për realizimin e fazave dhe aktiviteteve nga kontraktori të përcaktuara paraprakisht;
- ✓ Detyrime të tjera të kontraktorit.

Grupi i monitorimit gjatë realizimit të detyrave të ngarkuara, njofton me shkrim titullarin e autoritetit në lidhje me problematikat që konstatojnë gjatë procesit të hartimit të Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike si dhe sugjerojnë masat e nevojshme për zgjidhjen e problemeve dhe zbatimin e detyrimeve kontraktuale dhe tekniko-ligjore nga ana e kontraktorit.

## 9. MIRATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike i hartuar nga kontraktori, pasi ti nënshtrohet konsultimit me aktorët e fushës (Nj.A. shoqatat, komunitetin, specialistë të fushës) do të dërgohet për miratim në Këshillin Bashkiak të Tiranës e më pas dërgohet zyrtarisht për konfirmim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

## 10. REFERENCA LIGJORE

Gjatë hartimit të termave të referencës dhe përlllogaritjes së fondit limit, janë mbajtur në konsideratë detyrimet që lindin nga kuadri ligjor në fuqi në fushën e ndryshimeve klimatike dhe në fushën e prokurimit publik.

Kuadri ligjor përkatës përbëhet nga:

- Ligji Nr. 155/2020 “Për Ndryshimet Klimatike”
- Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (i ndryshuar);
- Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik”, i ndryshuar;
- Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Veprimit;
- Urdhër i Zv/Kryetarit të Bashkisë Nr. 1268, datë 24.04.2024 dhe nr. 15657/1 prot., datë 24.04.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e termave të referencës dhe përcaktimin e fondit limit konform legjislacionit në fuqi për realizimin e shërbimit për hartimin e planit të veprimit për Ndryshimet Klimatike”.

Nr	Emërtimi/Përshkrimi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Vlera
<b>I.</b>				
1.1	Hartim i Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike	1		
<b>Çmimi NETO</b>				
<b>TVSH 20 %</b>				
<b>Çmimi TOTAL</b>				

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRZGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese

---

brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021,2022,2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**2.2.2** Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2021,2022,2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

### **2.3 Për kapacitetin teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

